



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:070049

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05600098

P.nr.45/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurit S (Rr) G nga P, objekti K, D, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1, të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr.48/23, të dates 14.03.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit te Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurit te lartcekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 17.04.2024 në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 22.04.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

I pandehuri S. G, i lindur me date ne fsh P. K, ndërsa tani me banim P, Objekti K. D, me nr. personal, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i biri R, dhe nenës N, e gjinisë K, me profesion i papune, jetojnë nga ndihma sociale, i nacionaliteti shqiptar, shtetas i Kosovës, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjer me dt., në fsh P, K e K, në shtëpinë e tij, në rr me qëllim që vetes ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, siguron shërbime për të cilat dihet se

mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që pas kontrollit të ekipit profesional të K në njehsorin elektrik me nr (Grupi tarifor 4/02) kanë konstatuar se mbajtësit e bllobave tek bulonat ishin të prerë si dhe kishte gjurmë të manipulimit të bulonave dhe urave të tensionit në sistemet e tri fazave R,S dhe T, në brendësi të njehsorit kishte shenja të fërkimit në disk si dhe pluhur natyral dhe te releut tarifor me ç' rast i pandehuri me veprimet e sipërshënuara, në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me aparaturat e cekura si në procesverbalin me nr i dt, ku të dëmtuarës K i ka shkaktuar dëme materiale në vlerë prej 325,34 euro,

-me këtë ka kryer vepër penale "Vjedhja e shërbimeve" nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 40 par 3, 43 dhe 69, 70 si dhe nenit 314 par 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.LIROHET: I pandehuri nga shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe nga tarifa për kompenzim të viktimave të krimit, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

IV Udhëzohet: pala e dëmtuar K- D. L në P, që kërkesën pasurore juridikë ta realizojnë në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjen nr PP//II.nr.48/23, të dates 14.03.2023, ndaj te pandehurit S (Rr) G nga P, objekti kompania D, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1, të KPRK-se.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.04.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, i akuzuari S. G.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri se e e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohem, jam penduar thelle për veprën e kryer, i premtoj gjykatës nuk do te përsërisë vepra të tilla, apo te ngjashme penale. E kam gruan e sëmure qe 8 muaj, e cila është për trajtim ne Itali dhe vuan nga një sëmundje e rende (kanceri), jetoje vetëm nga një ndihma sociale, jam i papune, kërkoje nga gjykata qe te me shqiptojë një dendum me te bute.

Prokurori i Shtetit deklarohet: Pasi që i pandehuri S. G e pranoj fajësisë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet te tillë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden ne shkresa të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga e të pandehurit për veprën penale që i vihet ne barre, dhe me rastrin e marrjes se vendimin, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 par. 1 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që

përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: -Se i akuzuari, ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës PP//II.nr.48/23, të dates 14.03.2023, së Prokurorisë Themelore në në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, është hera parë që ka ra ndesh me ligjin, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Është mbajtës i vetëm i familjes, i njëjti ka deklaruar se e ka bashkëshorten e sëmurë, nga sëmundja e rëndë që 8 muaj e cila duke u trajtuar në Itali , jetoj nga ndihma sociale, dhe jam i pa punë. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti.

I pandehuri i ka dorëzuar gjykatës dëshminë se është shfrytëzues i skemës sociale me nr. të regjistrimit 53846 e lëshuar me dt. 13.03.2023.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me kusht i shqiptuar si në dispozitiv të këtij dhe duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet u mor konform nenit 452 par. 1 të KPRK-së

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 370 par 8 lidhur me par 6 dhe 1, si dhe neni 364 dhe 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.45/2023 me datë 22.04.2024

Zyrtare ligjore

Liridona Palushi

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.